



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2024-004

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës – Fejzullah Rexhepi, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga I.H., kundër Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë, A.B., më datë 29.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET SI E PABAZUAR, ankesa e parashtruar nga I.H., kundër Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë, A.B..

A r s y e t i m

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës më 6 shkurt 2024, konform nenit 9 par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka përcjellë ankesën e palës I.H., ndaj kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë – A.B., tek Kryetari i Gjykatës Supreme si Autoritet Kompetent, sa i përket pretendimeve të shkeljeve disiplinore të Kryetarëve të Gjykatave Themelore dhe Kryetarit të Gjykatës së Apelit (neni 9 par.1 nënpar.1.2 i ligjit të lartcekur).

Pala ankuese I.H., në ankesën e tij kundër kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë, A.B., ka paraqitur pretendimet e tij se kryetari kundërligjshëm ka refuzuar disa herë përjashtimin e gjyqtarit B.A., në çështja e tij juridike civile C.nr.477/2023, duke shtuar se nën trysni dhe me të padrejtë, ka vendosur që i njëjti të jetë gjyqtari në lëndën e tij C.nr.477/2023.

Derisa, në ankesën e tij pala shton se nëse kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë A.B., nuk vepron sikurse në përgjigje e tij, GJA.nr. 566/23 të datës 21.12.2023 do të shkojmë në Gjykatën e Apelit me raportim dhe ankesë të re për përjashtimin e gjyqtarit B.A..

Kryetari i Gjykatës Supreme pas shqyrtimit të pretendimeve në ankesës vlerësoi se:

- Ankesa është e pabazuar.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesi i ankesës si dhe shkresave të lëndës, si autoritet kompetent vlerësojë se në rastin konkret nuk ka bazë ligjore për të hapur rast disiplinor ndaj kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë, A.B., për këto arsye:

Së pari, me ankesë nuk kemi një përshkrim konciz të aspekteve faktike dhe juridike mbi të cilat është ngritur ankesa për shkelje disiplinore të kryera nga kryetari i Gjykatës.

Se dyti, ankesa është dukshëm jo serioze, sepse nga shkresat e lëndës rezulton se kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë – A.B., brenda kompetencave të tij ligjore dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi me përgjigjen GJA.nr. 566/23 të datës 21.12.2023 ia ka bërë të ditur palës së kërkesën për përjashtim ia ka drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për gjyqtarin e B. A., nga të cilët ka pranuar përgjigje se për vendosje lidhur me kërkesën është Kryetari i Gjykatës. Tutje përmes përgjigjes së kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë, pala është njoftuar rreth përmbajtjes që duhet të ketë kërkesa për përjashtim, duke iu referuar dispozitave ligjore për përjashtimin e gjyqtarit konform Ligjit për Procedurën Kontestimore, si dhe me faktin se me rastin e dorëzimit të kërkesës duhet të paguhet taksa gjyqësore.

Pra, nga shkresat e lëndës, rezulton se pala kërkesën për përjashtim të gjyqtarit nuk e kishte paraqitur tek Kryetari i Gjykatës por tek Këshilli Gjyqësor. Si rrjedhim kryetari i Gjykatës A.B., është përgjigjur në kërkesën e palës me shkresën e evidentuar me GJA.nr. 566/23 të datës 21.12.2023, në të cilën theksohet fakti se pala iu kishte drejtuar KGJK-së dhe Ministrisë së Drejtësisë me kërkesën për përjashtim të gjyqtarit, dhe jo Kryetarit të Gjykatës si organ kompetent për vendosje.

Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në mënyrë shprehimore në nenin 5, ka paraparë rastet në të cilat konsiderohet se është kryer shkelje disiplinore, në rastin konkret rezulton se veprimet e kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë, A.B., nuk kanë konsumuar ndonjë nga shkeljet e parapara me këtë Ligj.

Duke u bazuar në këto, kryetari i Gjykatës Supreme vlerëson se një ankesë e tillë në bazë të këtyre pretendimeve është e pabazuar.

Andaj, për shkak se në parashtrësën e palës, nuk potencohet ndonjë shkelje konkrete e supozuar disiplinore, të cilat janë të parapara në nenin 5 të ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Fejzullah Rexhepi
Kryetar i Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë,
3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.